



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Kolegjit Universitar "Tirana
Business University College"
Qershor 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- | | | |
|---|------------------------|---------|
| 1 | Z. Grant Horsburgh | Kryetar |
| 2 | Profesor As. Ana Kapaj | Anëtare |
| 3 | Z. Kevin Kendall | Anëtar |

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	5
Raport i detajuar	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	10
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	14
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	18
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	22
Lista e dokumenteve	26

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë mase institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që mbështetet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'iu ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikës së mirë, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

IAL-ja "Tirana Business University" (TBU) është një institucion privat i arsimit të lartë që ofron programe të ciklit të parë dhe të dytë në lëndë të përgjithshme të administrimit të biznesit, ekonomisë dhe juridikut. TBU-së i është dhënë akreditimi i saj institucional dhe të programeve të studimit në vitin 2013. Universiteti u themelua në vitin 2010 me qëllim ofrimin e përvojës së mësimdhënies dhe mësimnxënies me cilësi të lartë për grupe të vogla studentësh, për arritjen e një shkalle të lartë të punësimit të të diplomuarve.

Gjatë kryerjes së vizitës së vlerësimit, TBU-ja përbëhej nga dy njësi kryesore dhe katër departamente: Fakulteti i Administrim Biznesit, që përbëhej nga Departament i Lëndëve të Përgjithshme dhe Departamenti i Lëndëve Profesionale, dhe Fakulteti i të Drejtës së Biznesit, që përbëhej nga Departament i Lëndëve të Përgjithshme dhe Departamenti i Lëndëve Profesionale. Gjithashtu, secili fakultet ka qendrën e tij të kërkimit, përkatësisht Qendrën për Studime dhe Kërkime Ekonomike dhe Qendrën për Studime dhe Kërkime Ligjore, si dhe shtatë njësi administrative. Universiteti ka punësuar 16 pedagogë me kohë të plotë dhe 33 me kohë të pjesshme, dhe ofron dy programe studimi të ciklit të parë (Bachelor) dhe 12 programe studimi të ciklit të dytë (10 programe studimi të Masterit Profesional dhe dy të Masterit të Shkencave). Në programet e TBU-së janë të regjistruar gjithsej 287 studentë në Bachelor, 23 në Masterin e Shkencave dhe 151 në Masterin Profesional. **[RVV fq.4; M3; informacion për IAL-në faqen e APAAL-it]**

Raport i përmbledhur

“Tirana Business University” (TBU) është institucion privat i arsimit të lartë që i akomodon studentët në godina të marra me qira, në qendër të qytetit, dhe që e ushtron veprimtarinë e tij në formën aktuale që prej vitit 2010. TBU-ja ka afërsisht 461 studentë dhe ofron dy programe të ciklit të parë (Bachelor) dhe 12 të ciklit të dytë (10 programe studimi të Masterit Profesional dhe dy të Masterit të Shkencave). Universiteti ka 16 pedagogë me kohë të plotë, që janë të ndarë në dy fakultete: Fakultetin e Administrim Biznesit dhe Fakultetin e të Drejtës së Biznesit. Gjithashtu, secili fakultet ka qendrën e tij të kërkimit (përkatësisht Qendra për Studime dhe Kërkime Ekonomike dhe Qendra për Studime dhe Kërkime Ligjore), si dhe shtatë njësi administrative.

Një grup i vogël i përbërë prej katër anëtarësh, njëri prej tyre ishte kryetari i Zyrës së Çështjeve Studentore dhe një tjetër student i nivelit Master, hartoi raportin e vetëvlerësimit (RVV). Grupi u kryesua nga kryetari i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe kishte përfaqësues nga stafi akademik i të dy fakulteteve. Projektraportet iu shpërndanë në mënyrë elektronike një audience të gjerë brenda universitetit, duke përfshirë Këshillin e Studentëve, përpara përfundimit dhe miratimit nga Senati Akademik dhe Bordin e Administrimit. Megjithatë i dobishëm për ofrimin e informacionit të përshtatshëm lidhur me politikën dhe procedurat institucionale për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, raporti i vetëvlerësimit ishte kryesisht përshkrues dhe nuk paraqiste vlerësimin e efikasitetit të politikave dhe procedurave.

Vizita u realizua gjatë dy ditëve, përkatësisht në datat 12 dhe 13 qershor të vitit 2017. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të nivelit të lartë për arsimin e lartë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një ekspert me përvojë në arsimin e lartë, anëtar i personelit të institucioneve shqiptare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe një mbajtës shënimesh, të caktuar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë në Shqipëri (APAAL). Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion raporti i vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të plotësuar më pas nga dokumentet e kërkuara shtesë, para dhe gjatë vizitës. Një gamë e gjerë informacioni mbështetës, e siguruar nga TBU-ja, i mundësoi grupit të njihje me strukturën, politikën dhe procedurat e menaxhimit, dhe me natyrën e mësimdhënies dhe veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga institucioni. Këto dokumente përfshinin Statutin e universitetit, rregulloret akademike, raportin vjetor të Ministrisë, një larmi raportesh të brendshme, procedurat e pranimit dhe orientimit, listën e marrëveshjeve të jashtme dhe memorandumeve, shembujt e informacioneve rreth programit, si dhe evidencat e mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës së vlerësimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me drejtuesit e lartë, grupin e vetëvlerësimit, studentët, pedagogët, personelin mbështetës dhe administrativ, si dhe me partnerët e jashtëm dhe alumni. Diskutimi shërbeu për qartësimin e procedurave, përgjegjësi dhe pikëpamjeve. Gjatë të gjitha mbledhjeve u mbajtën shënime. Si pjesë të turit në ndërtesat e tij, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekën, auditorët, sallat kompjuterike, ambientet e përbashkëta të studentëve dhe zyrat.

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë, nuk identifikoi disa dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë. Strukturat institucionale funksionojnë në përputhje me Statutin dhe komisionet e tij të ngritura zyrtarisht për garantimin e menaxhimit të efektshëm. Universiteti ka një Strategji aktuale dhe të përshtatshme të Zhvillimit, dhe dokumentet evidentojnë efikasitetin e monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm të të gjithë veprimtarive. Kërkimi i tregut është një pikë e fortë institucionale. Megjithatë, marrëveshjet ndërkombëtare janë ende në hapat e para për t'u zhvilluar.

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi karakteristika të praktikës së mirë dhe nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i dha universitetit dy rekomandime, për t'u marrë në konsideratë në synimin e sigurimit të mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij. Mungesa e një sistemi të koordinuar të informacionit të mbrojtur me fjalëkalim personal (mjedis i mësimnxënies virtuale) përbën dobësi dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që universiteti ta shqyrtojë atë dhe të instalojë softuerë të përshtatshme, për mundësimin e aksesit në informacion personal dhe të burimeve përkatëse të mësimdhënies dhe mësimnxënies së përshtatshme për secilin program studimi (**Kapitulli III Standardi VII.1**). Fakti që godina e TBU-së nuk iu siguron studentëve me aftësi të kufizuara fizike aksesin e duhur përbën dobësi, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që universiteti të zhvillojë dhe zbatojë një plan të përcaktuar për sigurimin e aksesit të studentëve me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies (**Kapitulli III Standardi VII.3 dhe Kapitulli III Standardi VII.5**).

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të **praktikës së mirë**; lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet mësimdhënies dhe zbatimit të teorisë së përvetësuar në programet e studimit Bachelor dhe Master, gjë që i nxit punëdhënësit të ofrojnë një numër të madh vendesh pune (**Kapitulli III Standardi VII.1**). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur pjesërisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të **praktikës së mirë**; praktikën e TBU-së në lidhje me publikimin e rezultateve të kërkimit, nëpërmjet një politikë efikase të mbështetjes për organizimin, menaxhimin dhe mbajtjen e seminareve ndërkombëtare dhe simpoziumeve shkencore (**Kapitulli II Standardi I.7**). Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha tre rekomandime që universiteti të marrë në konsideratë sigurimin e mëtejshëm të cilësisë dhe standardeve të programeve të tij, dhe përmirësimin e mëtejshëm të përvojave të mësimnxënies për studentët e tij. Mungesa e prioritetëve specifike të kërkimit, analizës dhe diskutimit brenda departamenteve përbën dobësi, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që universiteti të garantojë se departamentet marrin përgjegjësinë e tyre për nxitjen, koordinimin dhe menaxhimin e punës kërkimore shkencore të grupeve të ngritura për veprimtarinë kërkimore (**Kapitulli II Standardi I.1**). Mungesa e strategjisë formale të kërkimit për orientimin e prioritetëve të kërkimit në nivel institucional dhe departamenti përbën dobësi, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që universiteti të zhvillojë dhe zbatojë një strategji formale të kërkimit për orientimin e prioritetëve të kërkimit në nivel institucional dhe departamenti (**Kapitulli II Standardi I.4 dhe Kapitulli II Standardi I.5**). Mungesa e veprimtarisë ndërkombëtare të kërkimit dhe mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve përbën dobësi, dhe Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që universiteti të lidhë marrëveshje dypalëshe dhe projekte për lehtësimin e veprimtarisë ndërkombëtare të kërkimit dhe mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve (**Kapitulli II, Standardi I.3 dhe Kapitulli II, Standardi I.6**). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një karakteristikë të praktikës së mirë; rolin proaktiv të Zyrës së Karrierës në lidhjen dhe vazhdimësinë e marrëveshjeve të partneritetit me bizneset private dhe bankat, të cilat mundësojnë punësimin në shkallë të gjerë të studentëve (**Kapitulli I, Standardi III.9**). Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi dhe nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

TBU-ja e ndërmori vlerësimin në përputhje me udhëzimet e APAAL-it. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerësoi shkallën e angazhimit të universitetit gjatë procesit dhe bashkëpunimin, që iu ofrua gjatë fazës së vizitës.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet mësimdhënies dhe zbatimit të teorisë së përvetësuar në programet e studimit Bachelor dhe Master, që i nxit punëdhënësit të ofrojnë një numër të madh vendesh pune (pika 3.10; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- praktikën e TBU-së në lidhje me publikimin e rezultateve të kërkimit, nëpërmjet një politikë efikase të mbështetjes për organizimin, menaxhimin dhe mbajtjen e seminareve ndërkombëtare dhe simpoziumeve shkencore (pika 4.9; **Kapitulli II Standardi I.7**)
- rolin proaktiv të Zyrës së Karrierës në lidhjen dhe vazhdimësinë e marrëveshjeve të partneritetit me bizneset private dhe bankat, të cilat mundësojnë punësimin në shkallë të gjerë të studentëve (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një sistemi të koordinuar të informacionit të mbrojtur me fjalëkalim personal (mjedisi i mësimnxënies virtuale) (pika 2.8; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- faktin që godina e TBU-së nuk përmbush si duhet kërkesat lidhur me aksesueshmërinë e studentëve me aftësi të kufizuara fizike (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.3 dhe Kapitulli III Standardi VII.5**)
- mungesën e prioriteteve specifike të kërkimit, analizës dhe diskutimit brenda departamenteve (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.1**)
- mungesën e strategjisë formale të kërkimit për orientimin e prioriteteve të kërkimit në nivel institucional dhe departamenti (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.4 dhe Kapitulli II Standardi I.5**)
- mungesën e veprimtarisë ndërkombëtare të kërkimit dhe mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.3 dhe Kapitulli I Standardi I.6**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- universiteti të shqyrtojë dhe të instalojë softuerë të përshtatshëm për mundësimin e aksesit në informacion personal dhe të burimeve përkatëse të mësimdhënies dhe mësimnxënies të përshtatshme për secilin program studimi (pika 2.8; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- universiteti të zhvillojë dhe të zbatojë një plani të përcaktuar për sigurimin e aksesit të studentëve me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.3 dhe Kapitulli III Standardi VII.5**)
- universiteti të marrë në mënyrë të ngutshme masa për sigurimin e nxitjes, koordinimit dhe menaxhimit të punës kërkimore shkencore të grupeve të ngritura për veprimtarinë kërkimore (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.1**)
- universiteti të zhvillojë dhe zbatojë në mënyrë të ngutshme një strategji formale të kërkimit për orientimin e prioriteteve të kërkimit në nivel institucional dhe departamenti (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.4 dhe Kapitulli II Standardi I.5**)

- universiteti të kërkojë në mënyrë të ngutshme të lidhë marrëveshje dypalëshe dhe projekte për lehtësimin e veprimtarisë ndërkombëtare të kërkimit dhe mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.3 dhe Kapitulli I Standardi I.6**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë **përbushur kryesisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur pjesërisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht**.

Gjykim i përmbledhur

Ekspertët i rekomandojnë Këshillit të Akreditimit se në “Tirana Business University”, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë **përbushur kryesisht**.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

1.1 Qeverisja e TBU-së dhe kuadrot e tij rregullatore janë hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit shtetëror për institucionet e arsimit të lartë. **[RVV fq.8]** Statuti i tij përcakton misionin e universitetit, dhe strukturat e brendshme organizative dhe drejtuese. **[8; A15]** Përgjegjësitë individuale dhe formale të bordeve dhe këshillave janë përcaktuar gjithashtu në rregulloret e universitetit. **[9]** TBU-ja e amendon dhe e ndryshon Statutin dhe rregulloret e tij sipas nevojave. **[6; 7; A11-13]** Statuti aktual u hartua në vitin 2016, duke u përshtatur sipas dispozitave të ligjit të ri për arsimin e lartë, dhe aktualisht është në pritje të miratimit nga Ministria e Arsimit. **[8; A15; M1-M3]** **[Kapitulli III Standardi I.1]**

1.2 Universiteti është i organizuar në atë mënyrë që të sigurojë menaxhimin efikas në përputhje me kërkesat ligjore. **[RVV fq.8-9; 11; M1-3]** Dërgimi i informacionit nga departamentet te Senati, dhe qarkullimi vendimeve të Senatit te stafi dhe studentët realizohet me efikasitet. **[RVV fq.8-9; B44-50; M2-M5; M9; M10]** Marrëveshjet për menaxhimin dhe administrimin e universitetit, si dhe vendimmarrja kolegjiale, që marrin parasysh kërkesat ligjore, zbatohen dhe kuptohen nga stafi i të gjitha niveleve. **[RVV fq.8-9; B44-50; M2-M4; M9; M10]** **[Kapitulli III Standardi I.2]**

1.3 Bordet dhe këshillat e TBU-së mbledhen rregullisht dhe informacioni për pikat e axhendës që do të diskutohen i vihet paraprakisht në dispozicion të të gjithë stafit në format elektronik. **[RVV fq.9; 17; M2-M4; M9; M10]** Duke qenë se TBU-ja është një universiteti i vogël dhe se anëtarët e stafit janë në kontakt të shpeshtë me njëri-tjetrin lehtësojnë debatin konstruktiv dhe efikas. **[M2-M4]** Studentët dhe stafi pohuan se çështjeve të ngritura prej tyre iu është kushtuar vëmendja e duhur, nëpërmjet debatit konstruktiv nga bordet dhe këshillat. Si shembuj mund të përmendim ndryshimet në oraret mësimore dhe fleksibilitetin për datat e dhënies së vlerësimeve për studentët, që punojnë me kohë të plotë dhe për atletë elitë. **[M6]** Marrëveshjet për funksionimin e këshillave dhe bordeve vendimmarrëse, dhe për mbështetjen e diskutimeve dhe debateve kolegjiale kuptohen nga stafi dhe studentët. **[M2-M5; M9; M10]** Dekanët dhe përgjegjësit e departamenteve janë përgjegjës për monitorimin brenda departamentit të zbatimit të vendimeve të marra nga bordet dhe këshillat e universitetit. **[M2-M5; M9; M10]** **[Kapitulli III Standardi I.3; Kapitulli III Standardi II.3]**

1.4 TBU-ja sigurohet që të respektohen kufijtë e autonomisë së saj dhe që ajo ta ushtrojë autonominë e saj brenda kufijve të legjislacionit dhe rregulloreve në fuqi. **[RVV fq.9-10]** Vetëqeverisja është e dukshme në njësitë organizative akademike dhe administrative, veprimtaritë shkencore dhe akademike, dhe çështjet financiare dhe administrative. **[20; A27; B9; M2-M5; M9; M10]** Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë i raporton Senatit dhe ka autonomi operacionale për mbikëqyrjen e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm. **[RVV fq.9; 8; M3; M10]** Njësia ka një kryetar të përhershëm dhe përfaqësues nga çdo departament dhe nga Këshilli i Studentëve. Proceset e monitorimit përfshijnë analizën e pyetësorëve të studentëve, raportet e vetëvlerësimit të stafit dhe një gamë të dhënash statistikore. **[M11]** Bordi Ndërkombëtar Këshillimor është përgjegjës për garantimin që universiteti të përfitojë nga mundësitë e financimeve evropiane dhe angazhon ekspertë të jashtëm për mbështetjen e veprimtarive institucionale. Bordi ka krijuar lidhje me institucionet e arsimit të lartë në Holandë dhe Mbretërinë e Bashkuar, si dhe ka aplikuar për bursa në Erasmus+, ku deri më tani është pranuar një aplikim. **[RVV fq.10; M3-M5; M9; M10]** **[Kapitulli III Standardi I.4]**

1.5 TBU-ja ka një strategji zhvillimi të përshtatshme për periudhën 2012-2017, e miratuar nga Senati [RVV fq.10; 19; A29; B11]. Strategjia është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e universitetit, dhe është shqyrtuar gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të saj nga organet dhe këshillat drejtuese. [RVV fq.10; M3-M5; M9; M10] **[Kapitulli III Standardi I.5]**

1.6 Raporti Vjetor që i është dërguar Ministrisë përmban të dhëna për programet e studimit dhe mësimdhënies, kërkimin shkencor, stafin, projektet, si dhe çështje ekonomike dhe financiare. [RVV fq.10-11; 21; A31; B12] Procesi i hartimit bazohet në raportet e vlerësimit të brendshëm dhe vetëvlerësimit për veprimtaritë e departamentit dhe programit të studimit. Raporti përfundimtar i vihet në dispozicion bordeve dhe komisioneve përkatëse të universitetit, dhe është i disponueshëm për stafin dhe studentët në faqen e internetit të TBU-së. [RVV fq.11; linku 7; M2-M5; M9; M10] **[Kapitulli III Standardi I.6]**

1.7 Fakultetet dhe departamentet janë të organizuara në përputhje me kërkesat ligjore. Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. [RVV fq.11; 22; A32; B13; informacion për IAL-në në faqen e internetit të APAAL-it]. Megjithatë, duke qenë se universiteti është i vogël dhe disa prej anëtarëve të lartë të stafit luajnë shumë role kanë bërë që individët me role të larta administrative të ndjekin mbledhjet për arsye akademike. Megjithëse Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk gjeti prova për konflikt interesi, do të jetë meritë e universitetit që në të ardhmen të rishikojë ndjekjen nga ana e stafit të lartë drejtues të të gjitha mbledhjeve, për të parandaluar konflikte të mundshme të interesit. [M3-M5; M9; M10] Stafi akademik është i kualifikuar sipas kërkesave dhe ushtron autonomi dhe liri akademike gjatë mësimdhënies, kërkimit dhe të gjitha veprimtarive të tjera akademike. [RVV fq.11; 22; A32; B13; informacion për IAL-në faqen e APAAL-it]; M2-M5; M9; M10] **[Kapitulli III Standardi II.1]**

1.8 Universiteti ka një rrjet partnerësh në nivel kombëtar dhe rajonal, që përfshin institucione të arsimit të lartë, organe publike, banka dhe biznese private. [RVV fq.11-12; 24; Linqet 8 -9; A34] Stafi akademik, alumni dhe institucionet, që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikës profesionale, treguan se ka lidhje të forta ndërmjet organizatave vendore dhe rajonale, dhe departamenteve dhe programeve. Kjo, dhe kërkimi i tregut i ndërmarrë në nivel institucional, iu mundëson departamenteve të informohen si duhet dhe programeve të mbështeten te mundësitë e zhvillimit ekonomik rajonal. [RVV fq.11-12; M3-M6; M9; M10] Zyra e Karrierës ka mekanizma efikase për monitorimin e punësimit të të diplomuarve. Shihni gjithashtu pikën 5.9. [RVV fq.11-12; M2-M5; M7; M9; M10] **[Kapitulli III Standardi III.1; Kapitulli III Standardi III.2]**

1.9 Bordi Ndërkombëtar Këshillimor mbikëqyr zhvillimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me partnerët e huaj, ndërsa zyrat e departamentit kujdesen për mbikëqyrjen e bashkëpunimeve vendore dhe rajonale. [RVV fq.11-12; M2-M5; M7; M9; M10] Në këtë mënyrë, bashkëpunimi me organizata të tjera për sigurimin e praktikës profesionale për studentët administrohet në nivel departamenti me mbështetje nga Zyra e Karrierës. Shihni gjithashtu pikën 5.9. **[Kapitulli III Standardi III.3]**

1.10 Universiteti vlerëson se normat e mobilitetit të studentëve dhe stafit kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të ulëta, por stafi drejtues parashikon se pjesëmarrja në projektin Erasmus+ gjatë vitit akademik 2017-2018 do të ndihmojë në trajtimin e kësaj sfide të vazhdueshme, që është një fushë prioritare për t'u zhvilluar. [RVV fq.13-14; M2-M6; M9; M10] Pjesëmarrja e TBU-së në veprimtari ndërkombëtare po arrihet aktualisht nëpërmjet organizimit, në partneritet me institucione të tjera të arsimit të lartë, të konferencave dhe simpoziumeve. [RVV fq.13; linku 12; M2-M6; M9; M10] Shihni gjithashtu pikën 4.8. **[Kapitulli III Standardi III.4]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

2.1 TBU-ja i menaxhon burimet e saj në përputhje me kërkesat ligjore, Statutin dhe rregulloret, të cilat sigurojnë menaxhimin e efektshëm të tyre. [RVV fq.15-16; A9; A15; A17] Organigrama është e publikuar në faqen e saj të internetit, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në atë angleze. [RVV fq.15; <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/organigrama>] Kjo organigramë paraqet qartë strukturën administrative dhe akademike të TBU-së. [A20; A21] Struktura është përcaktuar gjithashtu në Statut, dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e TBU-së dhe stafit të saj janë përcaktuar në pjesën përkatëse të rregulloreve. [A15; A17] Aktualisht, stafi akademik përbëhet nga 16 pedagogë me kohë të plotë, të cilët mbështeten nga 38 pedagogë me kohë të pjesshme, që sjellin ekspertizë të rëndësishme në veprimtaritë e tyre të mësimdhënies dhe veprimtari të tjera për institucionin. [A1; A2; M3] Ndërkohë që stafi akademik me kohë të plotë ka një angazhim kontraktual për mësimdhënien prej 200 orësh në vit, stafi me kohë të pjesshme mund të zhvillojë 30 deri në 60 orë në vit. [B52; M4; M10] Megjithatë, stafi me kohë të plotë që u takua me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm nuk ishin të qartë për ngarkesën mësimore për të cilën ishin kontraktuar të realizonin. [M10] **[Kapitulli III Standardi IV.1; Kapitulli III Standardi II.2]**

2.2 Vendet e lira për staf, së bashku me kriteret e punësimit për pozicionet përkatëse, shpallen në faqen e internetit të TBU-së. [RVV fq.15; <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/mund-si-pun-simi>; M10] Aplikantët ftohen për intervistë dhe kandidatët e suksesshëm bien dakord dhe nënshkruajnë një kontratë pune. [B27; M10] Shumë prej anëtarëve të stafit akademik kanë përvojë pune në biznese, si dhe kualifikime akademike, dhe disa prej tyre kanë studiuar jashtë vendit. [A32] Rekrutimi bëhet në përputhje me rregulloret e TBU-së. [A38; B16] Sistemi i vlerësimit të stafit lehtëson ngritjen në detyrë të stafit sipas aftësive dhe ekspertizës së tyre. [M4] **[Kapitulli III Standardi IV.1]**

2.3 TBU-ja ka një sistem formal të komunikimit me stafin, nëpërmjet një kategorie në faqen e internetit. [RVV fq.15; <http://tbu.edu.al/al/lajme>] Kjo jep detaje për aktivitetet dhe veprimtaritë e ardhshme akademike dhe sociale, dhe stafi nxitet të marrë pjesë në to. Detajet për një larmi aktivitesh sociale dhe kulturore mund të gjenden në faqen e internetit. [<http://tbu.edu.al/al/studentet/aktivitete-sociale>] Stafi ndjek ditët kombëtare të informimit për rritjen e ndërgjegjësimit dhe dhënien e informacionit për programet e ofruara nga TBU-ja. [A2] Informacioni për këto aktivitete gjendet gjithashtu në faqen e internetit. [<http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/dite-informuese>] Përpos këtyre, TBU-ja nxit dialogun dhe veprimtaritë sociale për stafin dhe studentët, duke përfshirë sigurimin shëndetësor dhe shoqërorë të stafit. [B27; <http://tbu.edu.al/al/studentet/aktivitete-sociale>] **[Kapitulli III Standardi IV.2; Kapitulli III Standardi IV.4]**

2.4 Aftësitë e stafit vlerësohen në mënyrë periodike nga përgjegjësi përkatës i departamentit. [RVV fq.16; M4; M10] Dokumentet e shqyrtuara përfshijnë vëzhgimin e mësimdhënies dhe reagime të dhëna nëpërmjet pyetësorëve të studentëve. [B58] Çdo mangësi diskutohet me dekanin përkatës dhe merren masat e nevojshme për trajtimin e tyre. [M4; M10] Stafi i mësimdhënies ka ngarkesë mësimore relativisht të ulët, kështu që ka mundësitë për t'u angazhuar në veprimtari trajnuese dhe kërkimore. Disa pedagogë po punojnë aktualisht me programin e tyre të Doktoraturës. [A2] TBU-ja mbështet shkëmbimet ndërkombëtare dhe ka filluar bashkëpunimin me programin Erasmus+, por vetëm 20% e stafit kanë punuar jashtë vendit në pesë vitet e fundit. [Anketimi i stafit] Shihni gjithashtu pikën 4.8. **[Kapitulli III Standardi IV.3]**

2.5 Strategjia e Zhvillimit orienton prioritetet për secilin vit fiskal. [RVV fq.17; B11] Përgjegjësitë për menaxhimin financiar përshkruhen në Statut. [B3] Faza e parë e procesit të buxhetimit ka të bëjë me rënien dakord me departamentet për numrin e studentëve dhe llogaritjen e të ardhurave. [M5] Departamentet vlerësojnë gjithashtu

kostot e tyre për veprimtaritë akademike në konsultim me dekanët, dhe projektbuxheti i universitetit përgatitet më pas nga Administratori. **[B3; M5]** Buxheti diskutohet dhe dakordësohet në Senat, përpara miratimit përfundimtar nga Bordi i Administrimit. TBU-ja përgatit buxhetin financiar për tre vjet, dhe së fundmi e ka përditësuar atë, për t'i pasqyruar ndryshimet në Strategjinë e Zhvillimit. **[A29; A39]** **[Kapitulli III Standardi VI.1]**

2.6 Gjatë pesë viteve të para të ushtrimit të veprimtarisë së saj, TBU-ja pati humbje financiare që u mbuluan nga ortakët. **[RVV fq.17; A2]** Aktualisht, TBU-ja ka shënuar një bilanc pozitiv modest për vitin akademik 2016-2017. **[A2; M5]** Pasqyrat financiare përgatiten nga një kontabilist i certifikuar dhe auditohen nga një auditues i pavarur në përputhje me kërkesat e Statutit. **[A40]** Bilanci vjetor dhe raporti i auditit bëhen të disponueshëm në përputhje me legjislacionin. [\[www.qkb.gov.al\]](http://www.qkb.gov.al) **[Kapitulli III Standardi VI.2]**

2.7 Performanca në lidhje me buxhetin monitorohet çdo muaj, dhe mospërputhjet ndërmjet shumave aktuale dhe atyre të buxhetuara janë të vogla. **[RVV fq.17; M5]** Stafi akademik pohon se procesi i buxhetimit është transparent dhe se atij i ofrohen burimet e nevojshme për veprimtarinë e tij mësimore dhe kërkimore. **[M10]** **[Kapitulli III Standardi VI.3]**

2.8 Sekretaria mësimore është përgjegjëse për sistemimin dhe shpërndarjen e informacionit brenda universitetit. **[A2; M11]** Krahas faqes së internetit, stafi ka akses në intranetin e brendshëm. **[RVV fq.18; A2; M10; M11]** Faqja e internetit përmban informacion, duke përfshirë Statutin, rregulloret, strukturën dhe proceset dhe programet e ofruara nga universiteti. [\[http://tbu.edu.al\]](http://tbu.edu.al) Intraneti për stafin iu mundëson këtyre të fundit aksesin në dokumente të tjera që nuk bëhen publike. Megjithëse stafi dhe studentët kanë një adresë emaili të posaçme që ua ofron TBU-ja, nuk ekziston një sistem i koordinuar i informacionit të mbrojtur me fjalëkalim personal, ku studentët dhe stafi të kenë akses në informacion konfidencial, për shembull burime posaçërisht për mësimdhënien dhe mësimnxënien dhe notat e studentëve. **[A2; M6; M10; M11]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mungesën e një sistemi të koordinuar të informacionit të mbrojtur me fjalëkalim personal (mjedis i mësimnxënies virtuale) si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që universiteti të shqyrtojë dhe instalojë softuerët e përshtatshëm për mundësimin e aksesit në informacionin personal dhe të burimeve përkatëse të mësimdhënies dhe mësimnxënies, të përshtatshme për secilin program studimi. **[Kapitulli III Standardi VII.1; Kapitulli III Standardi VII.2]**

2.9 TBU-ja ofron ambiente dhe struktura të përshtatshme për kryerjen e veprimtarive akademike dhe shkencore. **[RVV fq.19-20; M5; turi te burimet e mësimnxënies]** Ai ka marrë me qira një godinë trekatëshe me sipërfaqe 1,600m², por ka në pronësi ambientet e mësimdhënies dhe mësimnxënies. **[RVV fq.19; M5; turi te burimet e mësimnxënies]** Universiteti ka një larmi klasash me kapacitet nga 20 deri në 90 studentë, plus dy salla kompjuterash, një bibliotekë, zyra, salla mbledhjesh, dhe pajisje të ndryshme, që nevojiten për mësimdhënien dhe mësimnxënien. TBU-ja ka edhe një Qendër Inkubatore të Biznesit, ku TBU-ja ofron mbështetje falas për studentët dhe të diplomuarit që duan të krijojnë bizneset e tyre. **[A2; turi te burimet e mësimnxënies]** Në vitin 2016, Ministria inspektoi TBU-në dhe pohoi se kapaciteti fizik, kushtet dhe burimet ishin të përshtatshme për qëllimet e tij. **[A45]** **[Kapitulli III Standardi VII.3; Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi V.1]**

2.10 Të gjithë auditorët janë të pajisura me projektorë, me disa tabela interaktive, dhe të gjitha sigurojnë mjedis të mirë për mësimnxënien. **[RVV fq.19-20; turi te burimet e mësimnxënies]** Të gjitha pajisjet janë dokumentuar si duhet, si dhe ruhen dhe zëvendësohen sipas nevojës. **[A41]** TBU-ja nuk ofron ambiente sportive ose sociale të

dedikuara, por studentët pohuan se ata kanë akses në ambiente të tjera, që janë të përshtatshme, dhe se nismat sportive kanë pasur sukses. **[M6; turi te burimet e mësimnxënies] [Kapitulli III Standardi VII.3; Kapitulli III Standardi VII.5; Kapitulli III Standardi V.1]**

2.11 TBU-ja ka një politikë të mbështetjes së studentëve me aftësi të kufizuara. **[RVV fq.36]** Prania e një ashensori mundëson akses në klasat e katit të dytë, por kati i tretë ku ndodhet biblioteka nuk është i aksesueshëm për studentët me aftësi të kufizuara. Gjithashtu, rampat në hyrje të godinës janë shumë të pjerrëta dhe të ngushta, dhe kufizojnë aksesin e karrigeve me rrota. **[turi te burimet e mësimnxënies]** TBU-ja nuk ka studentë me aftësi të kufizuara fizike, ndërsa stafi u shpreh se nëse në të ardhmen do të pranohen studentë me aftësi të kufizuara fizike, do të merren masa për katin e parë të godinës, që nevojat e tyre të përmbushen. **[M11]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i mendimit se mungesa e aksesit për studentët me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha ambientet e godinës së TBU-së përbën **dobësi**. Ai **rekomandon** që universiteti të zhvillojë dhe zbatojë një plan të përcaktuar për sigurimin e aksesit të studentëve me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies. **[Kapitulli III Standardi VII.3; Kapitulli III Standardi VII.5]**

2.12 Falë politikës së bashkëpunimit të ngushtë me bizneset, duke përfshirë ortakët, TBU-ja po zhvillon paketa trajnimi për bizneset në përputhje me strategjinë e saj të zhvillimit. Ajo ka zhvilluar trajnim profesional të posaçëm për ortakun e tij kryesor, dhe po planifikon që ta vazhdojë këtë në vitin pasardhës akademik. **[A2; A9; M5] [Kapitulli III Standardi VII.6]**

2.13 TBU-ja ka një sistem të arkivimit të informacionit, duke përfshirë informacion për programin dhe tezat e studentëve, si në format të shtypur, ashtu edhe në format elektronik. **[RVV fq.19-20; A2; A26; A44]** Ky është në përputhje me nenet përkatëse të Statutit. **[A15]** Secili anëtar i stafit ka gjithashtu mundësinë ta ruajë informacionin në mënyrë elektronike, i cili mund të ruhet si kopje rezervë edhe në një hard disk të jashtëm, në fund të çdo viti. Gjithashtu, i gjithë informacioni administrohet nga sekretaria mësimore. Ky informacion mund të përfshijë procesverbalet e takimeve, vendimet e marra, informacionin për programin dhe të dhënat e studentëve, të cilat arkivohen dhe ruhen për një afat kohor të pacaktuar. **[A2] [Kapitulli III Standardi VII.4; Kapitulli III Standardi V.2]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë.

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e një sistemi të koordinuar të informacionit të mbrojtur me fjalëkalim personal (mjedisi i mësimnxënies virtuale) (pika 2.8; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- faktin që godina e TBU-së nuk përmbush si duhet kërkesat lidhur me aksesueshmërinë e studentëve me aftësi të kufizuara fizike (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.3 dhe Kapitulli III Standardi VII.5**)

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- universiteti të shqyrtojë dhe të instalojë softuerë të përshtatshëm për mundësimin e aksesit në informacion personal dhe të burimeve përkatëse të mësimdhënies dhe mësimnxënies të përshtatshme për secilin program studimi (pika 2.8; **Kapitulli III Standardi VII.1**)
- universiteti të zhvillojë dhe të zbatojë një plani të përcaktuar për sigurimin e aksesit të studentëve me aftësi të kufizuara fizike në të gjitha ambientet e mësimnxënies dhe mësimdhënies (pika 2.11; **Kapitulli III Standardi VII.3 dhe Kapitulli III Standardi VII.5**)

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

3.1 TBU-ja ka një Strategji Zhvillimi, që përfshin programet e niveleve Bachelor dhe Master në fushën e administrim biznesit dhe të drejtës së biznesit. [RVV fq.22-23; B10; B11] Detajet për këto programe mund të gjenden në faqen e internetit të universitetit dhe studentët të mundshëm mund të kontaktojnë me universitetin nëpërmjet rrjeteve sociale. [www.tbu.edu.al; <https://www.facebook.com/tbu.edu.al/>] TBU-ja bashkëpunon me institucionet e arsimit të mesëm dhe drejtoritë arsimore rajonale, si dhe organizon vizita vjetore në shkollat e mesme e të gjithë vendit, për promovimin e programeve të tij. [A2; M6] Që prej vitit 2011, universiteti ka organizuar konkurse kombëtare, ku ekipet e nxënësve të shkollave konkurrojnë me njëri-tjetrin dhe paraqesin idetë më të mira për biznes, plane biznesi ose zhvillojnë lojën me role në një kontekst ligjor. [B15; M4; M6] Kjo lidhje me shkollat është e dobishme, krahas ditëve të hapura të organizuara nga Ministria, dhe Panairëve për Karrierën të organizuara nga Dhoma e Tregtisë. [M4] [Kapitulli I Standardi I.1; Kapitulli I Standardi I.3]

3.2 Administrimi i biznesit dhe e drejta e biznesit janë degët me të cilat identifikohet universiteti, por nuk ka plane për diversifikimin e tyre të mëtejshëm. [RVV fq.23-24; B11] Studentët e mundshëm aplikojnë në bazë të kriterëve të pranimit, të cilat janë shpallur në faqen e internetit, dhe përzgjedhja e mëtejshme e aplikantëve bëhet me anë të një interviste nga një panel pedagogësh. [A2; M6; <http://www.tbu.edu.al/al/lajme/kriteret-e-pranimit-neprograme-bachelor-per-vitin-akademik-2017-2018>] Parashikohen bursa për studentët, në bazë të meritës ose të nevojës për mbështetje ekonomike. [B55; M2] [Kapitulli I Standardi I.1]

3.3 Strategjia e Zhvillimit e ka përcaktuar punësimin e studentëve dhe zhvillimin e karrierës si prioritetin kryesor institucional. [RVV fq.23-24; B10; B11] Kjo është përfshirë në strukturën e programit dhe lëndët e studimit, si dhe është pasqyruar në rregulloret e programit dhe informacionin e ofruar në faqen e internetit. [B23-B26; www.tbu.edu.al] Kjo ofron gjithashtu një strukturë koherente që përputhet me kërkesat kombëtare për arsimim dhe formim në këto lëndë. [Kapitulli I Standardi I.2]

3.4 Rregulloret e çdo programi të studimit janë të publikuar, si për programin Bachelor, ashtu edhe për atë Master. [RVV fq.24-25; B23-B26] Rregulloret ofrojnë më shumë detaje për përmbajtjen e programit, duke përfshirë lëndët e zhvilluara, kreditet, orët mësimore, praktikën profesionale dhe vlerësimin. Programet janë në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, siç pasqyrohet në specifikat e programit, dhe lejon transferimin e studentëve në dhe nga universiteti. [B29] Aktualisht, universiteti ka të regjistruar 461 studentë, nga të cilët 360 i frekuentojnë kurset. [A1; M3] Nga 461 studentë të regjistruar gjithsej, 74 janë studentë me kohë të pjesshme në programin Master. [A1] TBU-ja parashikon hapësirë për studentët që punojnë me kohë të plotë, si dhe programe studimi të përshtatura në varësi të nevojave. Kjo ofron jo vetëm arsimim dhe aftësim për studentët e rinj, por përmbush edhe nevojën për të nxënëit gjatë gjithë jetës të studentëve më të vjetër. [A16; A31; A43; A51; M2; M3] [Kapitulli I Standardi I.4; Kapitulli I Standardi I.6; Kapitulli I Standardi I.7]

3.5 Ngarkesa e stafit akademik planifikohet me kujdes për përmbushjen e kërkesave të mësimdhënies së programeve të studimeve. [RVV fq.24-25; B52] Secili program ka një plan që detajon orët mësimore, për t'u realizuar në javë dhe në vit. [B30-B33] Universiteti ka 16 pedagogë me kohë të plotë, si dhe ka fleksibilitetin të punësojë deri në 33 pedagogë me kohë të pjesshme për mbulimin e mësimdhënies për të gjitha programet. [M3] Kjo mundëson që 30% e stafit akademik me kohë të plotë të merret me veprimtari kërkimore. [M4] Ngarkesa mësimore prej afërsisht 200 orësh në vit për stafin akademik me kohë të plotë nënkupton që raporti pedagog/student është 1:20 ose 1:12,

nëse përfshihet edhe stafi me kohë të pjesshme. Si rrjedhojë, këto shifra tregojnë se universiteti po funksionon mirë bazuar në kapacitetet e tij. **[Kapitulli I Standardi I.5]**

3.6 Programet e studimit të ciklit të parë (Bachelor) siç përshkruhen dhe përcaktohen në faqen e internetit, dhe programet e studimit iu ofrojnë studentëve njohuritë bazë, si edhe metodat dhe parimet shkencore. **[RVV fq.25-26; B23; B24; www.tbu.edu.al]** Ato mundësojnë një kalim progresiv nga cikli i parë i studimeve në ciklin e dytë, dhe zhvillimi i stazheve mundëson gjithashtu përparimin drejt punësimit në fushat përkatëse të studimeve. Stazhet janë zakonisht formë punësimi me pagesë dhe zgjasin nga 3 dhe 12 muaj. **[B33; B34; M7]** Numri relativisht i ulët i studentëve të rinj, që regjistrohet çdo vit në programet Bachelor i mundëson TBU-së ofrimin e kujdesit dhe mbështetjes personale për secilin student, veçanërisht gjatë fillimit të studimeve të tyre. **[Kapitulli I Standardi I.7; Kapitulli I Standardi I.8]**

3.7 Programet e studimit të ciklit të dytë (Master) përshkruhen edhe në faqen e internetit dhe rregulloret për programet. **[RVV fq.26-27; B25; B26]** Këto lehtësojnë diskutimin dhe analizën kritike, së bashku me rritje të vëmendjes ndaj kërkimit. TBU-ja pohon se i gjithë stafi akademik është i angazhuar në kërkimin shkencor, dhe shumë të tjerë, konkretisht pedagogë me kohë të pjesshme, janë të punësuar edhe në biznese jashtë universitetit, që iu mundësojnë atyre një panoramë të plotë e të dobishme të biznesit, në dobi të studentëve. **[A2; M7]** Të gjithë studentët ndjekin stazhet si pjesë e programit të tyre, dhe shumë prej tyre janë të punësuar me kohë të plotë, gjë që lehtëson krijimin e lidhjeve ndërmjet studimit dhe aplikimit praktik të teorisë në biznes. **[Kapitulli I Standardi I.9]**

3.8 Programet e studimit janë në përputhje me Procesin e Bolonjës, dhe megjithëse ka disa raste të mobilitetit të studentëve, ato janë sporadike, ku vetëm 93.90% e studentëve të anketuar pohuan se nuk kishin studiuar jashtë vendit si pjesë e programit të tyre. **[RVV fq.27; B29; Anketim i studentëve]** TBU-ja synon mobilitetin e studentëve në Evropë, dhe është pjesë e skemës Erasmus+, por deri më tani shifrat e pjesëmarrjes janë të ulëta. Anketimi i studentëve tregon se vetëm 6.1% e studentëve kanë studiuar jashtë vendit, si pjesë e kursit të tyre. **[M4; M6]** Shihni gjithashtu pikën 4.8. TBU-ja ka gjithashtu një kurs në të Drejtën Administrative Evropiane, i cili zhvillohet në gjuhën angleze, si dhe shtatë kurse të tjera, që një pjesë të materialeve janë në gjuhën angleze. **[C6]** Pavarësisht gjuhëve të huaja, veçanërisht anglishtes, që konsiderohet si prioritet i TBU-së, studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm nuk kishin aftësi të mira në gjuhën angleze. **[M6] [Kapitulli I Standardi I.10]**

3.9 Partnerët e jashtëm pohuan se TBU-ja ka krijuar lidhje të ngushta me biznesin dhe vendet e punësimit. **[RVV fq.26-27; M7]** Marrëdhëniet me universitetin përfshinin ofrimin e stazheve, sigurimin e lektorëve të ftuar, këshillim për sistemet e informacionit, këshillim të studentëve për karrierën, angazhim në konkurse, kontribut në zhvillimin e programit dhe ofrim të mundësive të punësimit. **[M7]** TBU-ja ka gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi me një sërë partnerësh të biznesit dhe përdor një format standard për t'i konfirmuar ato. **[B14; M2]** Zyra e Çështjeve Studentore, që administrohet nga një anëtar i stafit me kohë të plotë, që është njëkohësisht edhe student, përfaqëson studentët e TBU-së dhe nxit debatet, dhe veprimtaritë sociale, kulturore dhe sportive. TBU-ja e mbështet këtë veprimtari dhe ofron lehtësira. **[RVV fq.28; A2; M6; M11; turi te burimet e mësimnxënies] [Kapitulli I Standardi I.11; Kapitulli I Standardi I.12]**

3.10 Ndërthurja e teorisë me praktikën nëpërmjet të nxënit të zbatuar, stazheve, kërkimit të aplikuar dhe lidhjeve të industrisë, është prioritet për TBU-në. **[RVV fq.27-28; A2]** Zyra e Karrierës, së bashku me përgjegjësit e departamenteve dhe dekanët përkatës, është zyrtarisht përgjegjëse për ofrimin e këshillave ndaj studentëve dhe për gjetjen e vendeve të punës për ta. Për secilin student organizohet çdo semestër një takim prej 45

deri në 60 minuta, për t'i këshilluar ata në lidhje me punësimin, dhe shumë studentë arrijnë të punësohen para diplomimit. **[A2; M11]** Statistikat e punëshueshmërisë raportohen në raportin vjetor institucional dhe përmbledhen në raportin e vendeve të punësimit të të diplomuarve. **[B12; B53]** Lidhja e drejtpërdrejtë ndërmjet mësimdhënies dhe zbatimit të teorisë së përvetësuar në kontekstin praktik në programet e studimit Bachelor dhe Master, që i nxit punëdhënësit të ofrojnë një numri të madh vendesh pune, siç tregohet në pikën 5.9, përbën karakteristikë të praktikës së mirë. **[Kapitulli I Standardi I.11]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet mësimdhënies dhe zbatimit të teorisë së përvetësuar në programet e studimit Bachelor dhe Master, që i nxit punëdhënësit të ofrojnë një numri të madh vendesh pune (pika 3.10; **Kapitulli III Standardi VII.1**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

4.1 TBU-ja ka mekanizmat e duhura për të siguruar organizimin dhe dokumentimin e programeve të studimit. **[RVV fq.29-30; A17; A47-50]** Struktura e programit dhe përmbajtja e kurrikulës diskutohet dhe dakordësohet në nivel departamenti, dhe më pas në nivel fakulteti. **[M5; M10]** Versioni i miratuar nënshkruhet nga Rektori, dekani i fakultetit dhe përgjegjësi i departamentit. **[A56-59]** Syllabuset dhe kurrikulat e programeve të studimit janë hartuar për të përmbushur objektivat e përgjithshme të programit, që janë të përcaktuara shumë qartë në Statut dhe në planin strategjik. Në kurrikulat i jepet një rëndësi e madhe të nxënit praktik, që është një nga shtyllat kryesore të universitetit. **[A15]** Stafi akademik i përditëson materialet mësimore në mënyrë periodike dhe mban të dhëna për veprimtarinë mësimore në regjistrin e tyre, si një dokument zyrtar, që dokumenton frekuentimin e studentëve, rezultatet dhe orët mësimore të realizuara. **[M10; M11]** Materialet e mësimdhënies vihen në dispozicion të studentëve në formën e librave akademike, leksioneve të shtypura, manualeve, dokumenteve të mëparshme, medias dhe softuerëve. Infrastruktura dhe kapaciteti i klasave të universitetit janë të përshtatshme për numrin e studentëve dhe stafit. Ai ka dy salla kompjuterash që kanë përkatësisht 14 dhe 22 kompjutera në dispozicion të studentëve, të cilët mund t'i përdorin ato gjatë studimeve dhe orëve të tyre të lira. **[turi te burimet e mësimnxënies] [Kapitulli I Standardi II.1]**

4.2 Të gjitha rregullat e provimeve janë të miratuar dhe vihen në dispozicion të studentëve, si dhe afishohen në këndet e informacionit në oborrin e fakultetit, në periudha të ndryshme të vitit akademik, dhe në faqen e internetit. **[RVV fq.30; M11; <http://www.tbu.edu.al>]** Universiteti publikon rezultatet e vlerësimit ndërkohë që i përgatit ato në mënyrë konfidenciale. Notat e studentëve dorëzohen në sekretari dhe më pas iu shpërndahen studentëve në mënyrë individuale, nëpërmjet adresave të tyre të emailit. Studentët kanë në dispozicion shtatë ditë për të bërë një ankesë për notën e marrë. **[M6; M11]** Gjatë kësaj periudhe, studentët kanë të drejtën të kontaktojnë me pedagogun për çdo qartësim lidhur me performancën e tyre në provim dhe për notat e tyre. **[A46-50; A63]** TBU-ja iu jep diplomën zyrtare studentëve që kanë përmbushur kërkesat e programit të tyre. **[B54; B72]** Diploma shoqërohet me një suplement të saj, që ka të gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit që ata kanë ndjekur. **[B54; B72; M6; M11] [Kapitulli I Standardi II.2]**

4.3 Programet e studimit i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë, që përfshijnë njësitë e brendshme të sigurimit të cilësisë. **[RVV fq.30-31; B51; B68]** Njësitë e brendshme të sigurimit të cilësisë në nivel departamenti analizojnë vlerësimin e kurrikulës dhe përmirësimin e ambienteve lidhur me cilësinë e programit të studimit, si përdorimi i laboratorëve, përditësimet e dokumentacionit, mjetet e teknologjisë së informacionit, raportin e ngarkesës mësimore, metodat e mësimdhënies dhe mjetet e vlerësimit. **[B51; M11]** Stafi akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme vlerësohen rregullisht nga strukturat e universitetit me anë të pyetësorëve të studentëve, leksioneve të hapura dhe vetëvlerësimit. **[M5, M6; M10]** Gjetjet pasqyruar në Raportin Vjetor. **[B12]** Programet e studimit dhe kurrikulat janë objekt i përmirësimit të vazhdueshëm, me qëllim pasqyrimin e ndryshimeve të sugjeruara nga bizneset dhe partnerët e tjerë. Duke qenë se objektivi kryesor i TBU-së është ofrimi i njohurive teorike dhe praktike për studentët, ai është qartësisht i orientuar drejt nevojave të biznesit. **[M5, M7; M10] [Kapitulli I Standardi II.3]**

4.4 TBU-ja ka një politikë të qartë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. **[RVV fq.31]** Stafi i mësimdhënies i nënshtrohet vlerësimit të vazhdueshëm, që kryhet në tre mënyra: vlerësimi personal, pyetësorët e studentëve dhe vlerësimi nga përgjegjësit e

departamenteve dhe dekanët e fakulteteve. [M2; M5; M6; M10] Departamentet ftojnë folës të specializuar në një larmi fushash për të diskutuar temat përkatëse, duke sjellë vlera shtesë në klasë nëpërmjet rasteve reale nga jeta dhe shembuj praktikë që plotësojnë mësimdhënien teorike. [RVV fq.31; B12; M6; M10] **[Kapitulli I Standardi II.4]**

4.5 Në përputhje me ligjin përkatës për arsimin e lartë dhe Statutin, departamenti është njësia kryesore vendimmarrëse e mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit. Megjithatë, edhe pse ka evidenca të qarta që kjo realizohet për sa i përket funksioneve të tij lidhur me mësimdhënien, mësimnxënien dhe vlerësimin, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk mund të pohonte rolin e departamentit në theksimin e pikave të forta dhe të dobëta lidhur me kërkimin shkencor. [RVV fq.31-32; M10] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi si **dobësi** mungesën e prioriteteve specifike të kërkimit, analizës dhe diskutimit brenda departamenteve. Ai **rekomandon** që universiteti në mënyrë të ngutshme të marrë masa për sigurimin e promovimit, koordinimit dhe menaxhimit të punës së kërkimit shkencor të grupeve të ngritura për këtë qëllim. **[Kapitulli II Standardi I.1]**

4.6 TBU-ja ka një gamë të gjerë marrëveshesh dhe partneritetesh me bizneset shqiptare, për lehtësimin e objektivit institucional të përgatitjes së studentëve për tregun e punës. [A15; A31; B14; M2; M4; M5; M7] Studentët, përfaqësuesit e partnerëve dhe alumni pohuan se ky objektivi është drejt përmbushjes. [M6; M7] Gjithashtu, u vu re se TBU-ja i shfrytëzon kontaktet e krijuara me organizatat e biznesit, për ndërmarrjen e projekteve të kërkimit praktik të aplikuar. Kontrata më e rëndësishme që ata kanë është ajo me grupin BALFIN, një nga grupet më të mëdha të biznesit në Shqipëri. [A8; A9; <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/partner-t>] Megjithatë, ndërkohë që universiteti përcakton 8% të buxhetit të tij për kërkimin shkencor, stafi ishte i paqartë në lidhje me mënyrën se si mund të aksesohet ky financim për t'i mbështetur ata në veprimtarinë e tyre kërkimore. [C3; M10] **[Kapitulli II Standardi I.1; Kapitulli II Standardi I.2]**

4.7 Strategjia e Zhvillimit 2012-2017 nuk paraqet një strategji formale të kërkimit dhe nuk është e qartë lidhur me procesin e zhvillimit dhe dakordësimin të prioriteteve institucionale të kërkimit. [RVV fq.32; B11] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi si **dobësi** mungesën e strategjisë formale të kërkimit për orientimin e prioriteteve të kërkimit në nivel institucional dhe nivel departamenti. Ai **rekomandon** që universiteti në mënyrë të ngutshme të zhvillojë dhe zbatojë një strategji formale të kërkimit për orientimin e prioriteteve të kërkimit në nivel institucional dhe nivel departamenti. **[Kapitulli II Standardi I.4; Kapitulli II Standardi I.5]**

4.8 Universiteti e pranon se mobiliteti i studentëve dhe stafit ka qenë dhe vazhdon të jetë në nivele të ulëta, por stafi i lartë vlerëson se pjesëmarrja në projektin Erasmus+ në vitin 2017-2018 do të ndihmojë në trajtimin e kësaj sfide të vazhdueshme, që është fushë prioritare për zhvillim. [M2; M4; M5] TBU-ja është në hapat e parë të zhvillimit të marrëveshjeve ndërkombëtare të bashkëpunimit, por nuk ka zbatuar një proces formal për t'i mundësuar stafit të angazhohet në pozicione të përkohshme lidhur me mësimdhënien dhe veprimtarinë e kërkimit në institucione të huaja ose bashkëpunimin në projekte kërkimi. [RVV fq.32; 24; M2; M4; M5] Stafi me të cilin u takua Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se ata nuk kanë mundur të përfitojnë nga mundësitë e mobilitetit ndërkombëtar për veprimtari të tjera mësimore, kërkimore dhe akademike. **[Anketimi i stafit; M6; M10]** TBU-ja ka nënshkruar një marrëveshje me programin Erasmus+ Key Action 1, që do të zbatohet në vitin akademik pasardhës dhe që mund t'i ofrojë stafit mundësi mobiliteti ndërkombëtar. [RVV fq.10] Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi si **dobësi** mungesën e veprimtarisë ndërkombëtare të kërkimit dhe mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve. Ai **rekomandon** që universiteti në mënyrë të ngutshme të kërkojë të lidhë marrëveshje dypalëshe dhe projekte për

lehtësimin e veprimtarisë ndërkombëtare të kërkimit dhe mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve. [**Kapitulli II Standardi I.3; Kapitulli II Standardi I.6**]

4.9 TBU-ja i është përkushtuar mbështetjes së rezultateve të veprimtarive kërkimore të stafit dhe ka një mekanizëm të përshtatshëm për mbikëqyrjen e publikimit të rezultateve të kërkimit. [**RVV fq.32-34**] Rezultatet kërkimore dhe shkencore bëhen publike, nëpërmjet prezantimeve në konferenca, seminare dhe simpoziume, të organizuara në TBU dhe në faqen e internetit të universitetit. [**RVV fq.33-34; linku 12; linku 14; M5; M10**] Progresi i veprimtarisë së kërkimit vlerësohet në nivel departamenti. [**RVV fq.34**] Gjatë periudhës 2015-2017, Universiteti në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë organizoi 10 konferenca shkencore për publikimin e rezultateve të kërkimit të stafit. [**B42; <http://www.tbu.edu.al/al/rreth-tbu/konferenca-shkencore>**] Gjithashtu, rezultatet e kërkimit shkencor që janë të rëndësishme për zhvillimin e vendit dhe rajonit janë bërë publike falë partneriteteve dhe institucioneve vendore. [**<http://www.tbu.edu.al/al/rreth-tbu/aktivitete-ne-tbu>**] TBU-ja ndjek praktikën e publikimit të rezultateve të kërkimit, nëpërmjet një politikë efikase të mbështetjes për organizimin, menaxhimin dhe mbajtjen e seminareve ndërkombëtare dhe simpoziumeve shkencore, gjë që përbën **praktikë të mirë**. [**Kapitulli II Standardi I.7; Kapitulli II Standardi I.8**]

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- praktikën e TBU-së në lidhje me publikimin e rezultateve të kërkimit, nëpërmjet një politikë efikase të mbështetjes për organizimin, menaxhimin dhe mbajtjen e seminareve ndërkombëtare dhe simpoziumeve shkencore (pika 4.9; **Kapitulli II Standardi I.7**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësitë e mëposhtme:

- mungesën e prioriteteve specifike të kërkimit, analizës dhe diskutimit brenda departamenteve (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.1**)
- mungesën e strategjisë formale të kërkimit për orientimin e prioriteteve të kërkimit në nivel institucional dhe departamenti (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.4 dhe Kapitulli II Standardi I.5**)
- mungesën e veprimtarisë ndërkombëtare të kërkimit dhe mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.3 dhe Kapitulli I Standardi I.6**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- universiteti të marrë në mënyrë të ngutshme masa për sigurimin e nxitjes, koordinimit dhe menaxhimit të punës kërkimore shkencore të grupeve të ngritura për veprimtarinë kërkimore (pika 4.5; **Kapitulli II Standardi I.1**)

- universiteti të zhvillojë dhe zbatojë në mënyrë të ngutshme një strategji formale të kërkimit për orientimin e prioriteteve të kërkimit në nivel institucional dhe departamenti (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.4 dhe Kapitulli II Standardi I.5**)
- universiteti të kërkojë në mënyrë të ngutshme të lidhë marrëveshje dypalëshe dhe projekte për lehtësimin e veprimtarisë ndërkombëtare të kërkimit dhe mundësive për mobilitetin e stafit dhe studentëve (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.3 dhe Kapitulli I Standardi I.6**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur pjesërisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Fokusi kryesor i TBU-së për sa i përket rekrutimit, siç pasqyrohet edhe në Statut dhe strategjinë e zhvillimit, është përmirësimi i cilësisë dhe jo shtimi i numrit të studentëve. [RVV fq.34-35; B3; B11; M2; M5] Procedura e pranimit është në përputhje me kërkesat ligjore, që përfshihet edhe në strategjinë e zhvillimit. [B11] Çdo vit organizohen fushatat e promovimit të institucionit për studentë të mundshëm, duke përfshirë vizitat në shkollat e mesme dhe ditët e hapura. [M2; M5; M6] TBU-ja publikon manualët e studentëve dhe një larmi broshurash dhe fletëpalosjesh promovionale të programit. [turi te burimet e mësimnxënies] Për t'u ambientuar në universitet, studentët marrin pjesë në takime orientuese dhe udhëzuese, për t'iu ofruar atyre informacionin e nevojshëm për programin e tyre të studimit dhe për universitetin. [M6; M7] TBU-ja organizon konkurse për aplikantët që të identifikojnë individë me performancë të lartë, të cilët mund të kenë të drejtë të përfitojnë nga bursat, për të mbuluar të gjithë ose një pjesë të tarifës së tyre të regjistrimit. [B73; M2; M6] [Kapitulli I Standardi III.1]

5.2 Duke qenë një universitet i vogël, me një numër të kufizuar studentësh, komunikimi ndërmjet stafit dhe studentëve është i efektshëm. [M6] Çdo student dhe anëtar i stafit ka një adresë emaili personale për përdorim të brendshëm. [M4; M6] Informacioni personal i studentëve, duke përfshirë detajet e kontaktit dhe notat, ruhet në mënyrë të sigurt në Sekretari. [A21; M6; M11] Faqja gjithëpërfshirëse e internetit e institucionit, rrjetet sociale dhe emaili sigurojnë mjete komunikimi efikase me organizatat e brendshme. [RVV fq.35; www.tbu.edu.al; <https://www.facebook.com/tbu.edu.al/>] [Kapitulli I Standardi III.2]

5.3 Departamentet dhe çdo anëtar i stafit janë përgjegjës për procesin e mentorimit dhe tutorimit, një proces i vazhdueshëm gjatë gjithë periudhës së studimit. [A15] Stafi akademik me kohë të plotë ka orare javore të planifikuara për tutorimin e studentëve dhe ky informacion postohet në faqen e internetit dhe në intranet. [<http://www.tbu.edu.al>] Gjithashtu, Zyra e Karrierës luan një rol thelbësor në orientimin dhe mentorimin e studentëve, duke iu ofruar ndihmë gjatë studimeve të tyre dhe këshillim për stazhin dhe mundësitë e punësimit në të ardhmen. Nga diskutimet e zhvilluara me stafin dhe studentët, u pohua efikasiteti i marrëveshjeve të orientimit dhe të mentorimit. Studentët pohuan se atyre iu janë dhënë të gjitha këshillat e nevojshme gjatë studimeve të tyre, dhe se ata mund të kontaktojnë me stafin për këshillim individual gjatë orarit zyrtar të punës, gjatë leksioneve dhe seminareve. [M6; M7; M10] [Kapitulli I Standardi III.3]

5.4 TBU-ja jep bursa sipas meritës për studentët e ciklit të parë (Bachelor) për tre kategori studentësh: nxënës të shkollës së mesme me mesatare të lartë, fituesit e konkurseve kombëtare të organizuara nga TBU-ja, dhe talentet që kanë shkëlqyer në art, kulturë dhe sporte. [A15; B73; M2; M4-7] Ka edhe bursa për studentë të ciklit të dytë (Master), konkretisht për ata që kanë mbaruar studimet Bachelor me mesatare të lartë. [RVV fq.36] Universiteti jep gjithashtu bursa sipas nevojave për studentët romë, studentët që vijnë nga familje me të ardhura të ulëta, studentët me probleme shëndetësore, dhe jetimët. [B73; M6; M7] [Kapitulli I Standardi III.4]

5.5 Biblioteka e TBU-së shërben gjithashtu si hapësirë studimi dhe sallë kompjuterike për studentët. [RVV fq.37; turi te burimet e mësimnxënies] Biblioteka ka kapacitetet afërsisht për 820 libra, por gjatë vizitës nuk ishte i qartë numri i librave që kishte. [turi te burimet e mësimnxënies] Fondi i librave mbështetet nga një platformë online për

literaturën shtesë, që ofron akses në më shumë se 40,000 artikuj të autorëve, që janë ekspertë të fushave përkatëse, të cilët mund të aksesohen nga studentët në internet.

[M6; M7; M10] [Kapitulli I Standardi III.5]

5.6 Përpos proceseve të tutorimit formal, kontakti i përditshëm ndërmjet pedagogut dhe studentit iu mundëson studentëve të ciklit të parë mundësi të mëtejshme për mbështetje dhe progres. Mentorimi i posaçëm iu ofrohet studentëve të vitit të tretë të ciklit të parë, për t'i mbështetur ata gjatë zgjedhjes dhe hartimit të temës së diplomës dhe për t'i këshilluar rreth mundësive të punësimit në të ardhmen. **[A62; M6]** Zyra e Karrierës iu jep studentëve këshilla dhe udhëzime para dhe gjatë praktikës profesionale apo rreth mundësive të praktikës, dhe ata shoqërohen nga një pedagog në takimin e tyre të parë me ofruesin e praktikës. **[RVV fq.37; M10]** Ofrohet gjithashtu mbështetje për sa i përket mundësive të studimeve të mëtejshme në programet e ciklit të dytë. **[A60; A61; M4; M6; M11]** Studentëve me performancë të lartë iu ofrohet asistencë për regjistrimin në kurse shtesë ose për të ndjekur studime të avancuara, falë planit akademik individual. **[RVV fq.37; M6; M7; M10] [Kapitulli I Standardi III.6]**

5.7 TBU-ja nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në jetën universitare. Këshilli i tij i Studentëve është aktiv, në takimet e të cilat diskutohen çështje dhe ngrihen problematika, që lidhen me programet e tyre të studimit, materialet e studimit, ambientet e universitetit dhe veprimtaritë sociale, të cilat kërkojnë që përfaqësuesit e studentëve t'i delegojnë ato për zgjidhje në fakultet dhe Senat. Studentët që u takuan gjatë vizitës pohuan se Këshilli i Studentëve organizon veprimtari dhe trajton problemet e ngritura nga studentët gjatë vitit akademik. **[M6]** Studentët përfaqësohen në Senat me dy studentë dhe në Njësinë e Brendshme të Sigurimit të Cilësisë me një student. **[RVV fq.38; A21; A31; M4]** Megjithatë, disa studentë që u takuan gjatë vizitës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm nuk ishin në dijeni se kush ishte përfaqësuesi i studentëve. **[M6]** TBU-ja ofron mundësi për angazhimin në punë administrative të paguar, si p.sh. në Zyrën e Financës dhe Zyrën e Çështjeve Studentore. **[M2; M5] [Kapitulli I Standardi III.7]**

5.8 TBU-ja ndjek një politikë mbështetëse për sigurimin e cilësisë kulturore dhe sportive të jetës studentore. Studentët nxiten në mënyrë aktive të marrin pjesë në një larmi veprimtarish sociale, duke përfshirë aktivitete kulturore, festa ditëlindjesh, festën e Vitit të Ri, ceremoni për festat kombëtare, dhe veprimtari të tjera që organizohen për t'i nxitur studentët të shoqërohen dhe të njihen më mirë me njëri-tjetrin. **[RVV fq.38]** TBU-ja vlerëson talentet e studentëve dhe arritjet e tyre në sporte, art dhe kulturë, dhe është proaktive në tërheqjen e këtyre personave, nëpërmjet ofrimit të bursave dhe programeve individuale fleksible të studimit. **[B55; B73]** Më shumë se 10 studentë të angazhuar në sporte në mënyrë profesionale po studiojnë në një program studimi fleksibël. **[M6]** TBU-ja nuk ka ambiente sportive në kampusin e saj, por studentët kanë akses falas në ambiente të marra me qira. **[M6; M10] [Kapitulli I Standardi III.8]**

5.9 Punësimi i studentëve në të ardhmen është qëllimi dhe objektivi institucional kryesor. **[A15]** Statistikat e studentëve për vitin akademik 2015-2016 tregojnë se nga 60 të diplomuar në ciklin e parë (Bachelor) dhe 18 të diplomuar në ciklin e dytë (Master), përkatësisht 54 dhe 18 janë punësuar në profesionin për të cilin kanë studiuar. **[RVV fq.38; A1; M4; M7]** Studentët e kanë vlerësuar rolin e Zyrës së Karrierës në ofrimin e asistencës dhe mbështetjes lidhur me mundësitë e ardhshme të punësimit gjatë gjithë periudhës së tyre të studimit. **[M6]** Zyra e Karrierës i këshillon dhe i orienton studentët për zgjedhjen se ku dëshirojnë ta zhvillojnë stazhin ose praktikën profesionale. **[M6; M11]** Numri i madh i marrëveshjeve me pothuajse 50 kompani private dhe banka tregon që Zyra e Karrierës ka negociuar me bizneset private dhe bankat, dhe kjo është një pikë e fortë e universitetit. **[A8; A33; A34; B14; <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/partner-t>]** Partner kyç midis partnerëve të shumtë është grupi BALFIN, sponsori financiar i universitetit, që

është punëdhënësi më i madh për të diplomuarit e TBU-së. **[A9]** Roli proaktiv i Zyrës së Karrierës në lidhjen dhe vazhdimin e marrëveshjeve të partneritetit me bizneset private dhe bankat, që mundëson punësimin në shkallë të gjerë të studentëve, është karakteristikë e praktikës së mirë. Së fundi, Zyra e Karrierës ruan marrëdhënie të shëndosha pune me alumnit dhe i fton ata në çdo veprimtari akademike dhe sociale që ajo organizon. **[M7] [Kapitulli I Standardi III.9]**

Gjetje

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- rolin proaktiv të Zyrës së Karrierës në lidhjen dhe vazhdimësinë e marrëveshjeve të partneritetit me bizneset private dhe bankat, të cilat mundësojnë punësimin në shkallë të gjerë të studentëve (pika 5.9; **Kapitulli I Standardi III.9**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim të ndërmarrë.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur plotësisht.

Lista e dokumenteve

Lista 1

Këto dokumente janë renditur në faqet 41-43 të raportit të vetëvlerësimit me titull “Lista e Dokumenteve të TBU-së – Aneksë dhe Linqe”. Këto dokumente referohen në raport si '1', '2', etj.

Raporti i Vetëvlerësimit (RVV)

- 1 H1.1 Shkresë e ardhur nga MAS për riorganizimin - Prill 2017
- 2 H1.2 Shkresë e TBU dërguar MAS për riorganizimin institucional (MM)
- 3 H2 Rezultatet e bashkëpunimit mes TBU-së dhe Raiffeisen Bank
- 4 H3 Rezultatet e bashkëpunimit të TBU-së me Grupin Balfin
- 5 H4 Urdhër i Rektorit për fillimin e procesit për Strategjinë e Zhvillimit 2018-2023
- 6 1.1 Statuti 2012
- 7 1.2 Statuti 2014 (shqip dhe anglisht)
- 8 1.3 Statuti 2016 (shqip dhe anglisht)
- 9 1.4 Rregullore e Përgjithshme e TBU-së (shqip dhe anglisht)
- 10 1.5.1 Organigrama 2014 (shqip dhe anglisht)
- 11 1.5.2 Organigrama 2016 (shqip dhe anglisht)
- 12 1.6 Vendim i Senatit Akademik për përbërjen e stafit të Këshillit të Etikës
- 13 1.7 Kodi i Etikës i TBU-së
- 14 1.8 Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e Rektorit dhe Dekanëve
- 15 1.9 Miratim i Rektorit për emërimin e përgjegjësve të departamenteve
- 16 1.10 Procesi i vendimmarrjes për përmirësimin e kurrikulave
- 17 1.10-1 Vendim i Senatit për përbërjen e stafit të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë
- 18 1.11.1 Vlerësimi 2014 i Strategjisë së Zhvillimit (2012-2017)
- 19 1.11.2 Strategjia e Zhvillimit (2012-2017)
- 20 1.12 Procedura e vendimmarrjes për rishikimin në vitin 2014 të strategjisë dhe buxhetit afatmesëm (2015-2017)
- 21 1.13 Raporti Vjetor 2015-2016
- 22 1.14 Anëtarët e stafit akademik (viti akademik 2016-2017)
- 23 1.15 Marrëveshje Biznesi tip e TBU-së
- 24 1.16 Marrëveshje mes TBU-së dhe “School of American Law” [Shkolla e Drejtësisë Amerikane] (MM)
- 25 1.17 Korrespondencë zyrtare me Ministrinë e Arsimit për Konkursët Kombëtare të TBU-së (Sipërmarrësit edhe Juristët e së Nesërme) - 2016
- 26 1.18 Model Syllabusi me materiale për lexim në gjuhën shqipe dhe angleze
- 27 2.1 Rregullore për Rekrutimin e Personelit Akademik
- 28 2.2 Konkluzionet e Inspektimit të MAS për procedurat e rekrutimit të stafit akademik në TBU - Maj 2015
- 29 2.3 Procedura e hartimit të buxhetit (2017) dhe planifikimit të buxhetit (2017-2019)
- 30 2.4 Raporti i Auditimit 2015
- 31 2.5 Inventar i asetëve (harduerë, pajisje, etj.) deri më dhjetor 31, 2016
- 32 2.6 Raporti Vjetor 2014-2015
- 33 2.6-1 Projekti Erasmus - lista e asetëve
- 34 2.7 Shembull Syllabusi të një lënde me literaturën më të përditësuar
- 35 2.8 Raporti i MAS për inspektimin e kryer në TBU për kapacitetet pritëse - 2016
- 36 2.9 Rregullore për Sekretarinë Mësimore
- 37 3.1.1 Rregullore e Programit Bachelor në Administrim Biznesi, Profili Menaxhim
- 38 3.1.2 Rregullore e Programit Bachelor në të Drejtën e Biznesit

39	3.1.3 Rregullore e Programit Master Profesional në Administrim Biznesi
40	3.1.4 Rregullore e Programit Master Profesional në të Drejtën e Biznesit
41	3.2 Vendim Senati mbi strukturën akademike 2016-2017 dhe planet mësimore
42	3.3 Kontrata tip e punës për stafin akademik
43	3.4 Profili "Menaxhim" si model për vitin akademik 2014-2015
44	3.5.1 Rast ilustrimi për studentët e transferuar në TBU nga universitet jashtë vendit
45	3.5.2 Rast ilustrimi për studentët e transferuar në TBU nga universitet brenda vendit
46	4.1.1 Planet mësimore 2016-2017 Bachelor Administrim Biznesi
47	4.1.2 Planet mësimore 2016-2017 Bachelor E Drejtë Biznesi
48	4.1.3 Planet mësimore 2016-2017 Master Administrim Biznesi (të gjitha programet)
49	4.1.4 Planet mësimore 2016-2017 Master E Drejtë Biznesi
50	4.2 Rregullorja e Praktikës Mësimore/Internships
51	4.3 Vendim Dekani për përcaktimin e Mbikëqyrësit të Praktikës Mësimore (anëtar i stafit akademik)
52	4.4 Vendim i Përgjegjës të Departamentit për Temat e Diplomave dhe Udhëheqësit, për vitin akademik 2015-2016
53	4.5 Rregullore për Mbarëvajtjen e Procesit Mësimor
54	4.6 Udhëzime për Temën e Diplomës
55	5.1 Vendimi i Rektorit për ngritjen e komisioneve të posaçëm për pranimet e aplikantëve në vitin akademik 2016-2017
56	5.2 Shembull transferimi i një studenti nga programi Master Profesional në Master të Shkencave

Lista 2

Linqet e mëposhtme janë renditur në faqet 44-45 të raportit të vetëvlerësimit me titullin “*Lista e dokumenteve të TBU-së – Aneksë dhe Linqe*”. Këto dokumente referohen në raport si 'linku 1', 'linku 2', etj.

1. Dokumentet statusore ligjore të TBU-së (Statuti, Rregullore e Përgjithshme, etj.) <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/dokumenta-ligjore>
2. Organigrama e TBU-së <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/organigrama>
3. Përbërja e stafit të Këshillit të Etikës <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/keshilli-i-etikes>
4. Përbërja e stafit të NjSBC-së <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/sigurimi-i-cil-sis>
5. Bordi Ndërkombëtar Këshillimor <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/bordi-nd-rkomb-tar-k-shillimor>
6. Dhoma Gjermane e Tregtisë në Shqipëri (DIHA) <http://www.diha.al/anetaret/lista-e-anetareve/mitgliederverzeichnis-al/?L=131&cHash=-1>
7. Raportet Vjetore <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/raportet-vjetore>
8. Veprimtari akademike (seminare, leksione të hapura, vizita studimore) <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/aktivitete-ne-tbu>
9. Partnerët e TBU-së <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/partner-t>
10. Konkursi Kombëtar 2016 <http://tbu.edu.al/al/programet/konkursi-kombetar-2016>
11. Veprimtaria e kërkimit shkencor të anëtarëve të stafit akademik <http://tbu.edu.al/al/programet/veprimtaria-k-rkimore-shkencore>
12. Konferenca “E ardhmja e Evropës” <http://tbu.edu.al/al/lajme/konferenca-e-ardhmja-e-europ-s>
13. Punësimi në TBU <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/mund-si-pun-simi>
14. Lajme <http://tbu.edu.al/al/lajme>
15. Ditët Informuese të TBU-së (panaire dhe vizita në terren) <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/dite-informuese>
16. Aktivitete sociale <http://tbu.edu.al/al/studentet/aktivitete-sociale>

17. Informacion për programin Bachelor në TBU <http://tbu.edu.al/al/programet/programe-bachelor>
18. Informacion për programin Master në TBU <http://tbu.edu.al/al/programet/programe-master>
19. Qendra EiPass e TBU-së, e akredituar për ofrimin e trajnimeve të certifikuara në njohuritë e IT-së <http://tbu.edu.al/al/studentet/tbu-eipass-center>
20. Pyetje të shpeshta <http://tbu.edu.al/al/rreth-tbu/pyetjeteshpeshta>
21. Broshurë Informuese e TBU-së https://issuu.com/tiranabusinessuniversity/docs/tbu_broshura_e_programeve
22. Trajnim i mësuesve të shkollave së mesme JA në TBU <http://www.tbu.edu.al/al/lajme/tbu-trajnimi-i-m-suesve-nga-ja-of-albania>
23. Konkursi Kombëtar i TBU-së për sipërmarrësit dhe juristët e së nesërme - 2017 (adresa e internetit e skanuar në raportin e vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
24. Kriteret e pranimit në TBU për vitin akademik 2017-2018 (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
25. Seminare trajnimi të TBU-së (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
26. Informacion për studentët e punësuar (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
27. Linqe të dobishme për mundësitë e punësimit (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
28. Progresi i karrierës së studentëve të TBU-së (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
29. Sipërmarrja e studentëve të TBU-së (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
30. Studentët e TBU-së si pjesëmarrës dhe fitues të konkurseve kombëtare dhe ndërkombëtare (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
31. Alumni i TBU-së (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
32. Zyra e Karrierës dhe Orientimit të Studentëve (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
33. EBSCO (biblioteka online) (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
34. Konferenca ndërkombëtare të organizuara nga TBU-ja (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
35. Shtëpia botuese "TBU press" (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
36. Linku i Facebook i TBU-së (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)
37. Inkubatori i biznesit në TBU (adresa e internetit e skanuar në faqen 45 të raportit të vetëvlerësimit; format i paaksesueshëm)

Lista 3

Këto dokumente u dorëzuan si evidenca shoqëruese të raportit të vetëvlerësimit. Këto dokumente referohen në raport si 'A1', 'A2', etj.

- A1 Dokument me Informacion të Përgjithshëm
- A2 Raporti i Vetëvlerësimit i TBU-së - anglisht
- A3 Lista e plotë e përmbajtjes në Dosjen e Vetëvlerësimit
- A4 Raporti Vetëvlerësimit i TBU-së (RVB) - shqip
- A5 TBU - Vetëdeklarimi
- A6 Aneksi H1.1 - Shkresë e ardhur nga MAS për riorganizimin në prill 2017
- A7 Aneksi H1.2 - Shkresë e TBU dërguar në MAS për riorganizimin institucional
- A8 Aneksi H2 - Rezultatet e bashkëpunimit mes TBU-së dhe Raiffeisen Bank
- A9 Aneksi H3 - Rezultatet e bashkëpunimit të TBU-së me Grupin Balfin
- A10 Aneksi H4 - Urdhër Rektori për Strategjinë 2018-2023
- A11 Fusha 1 - Aneksi 1.1 - Statuti 2012
- A12 Fusha 1 - Aneksi 1.2 - Statuti 2014 - shqip
- A13 Fusha 1 - Aneksi 1.2 - Statuti 2014 – anglisht
- A14 Fusha 1 - Aneksi 1.3 - Statuti 2016 - shqip
- A15 Fusha 1 - Aneksi 1.3 - Statuti 2016 - anglisht
- A16 Fusha 1 - Aneksi 1.4 - Rregullorja e Përgjithshme - shqip
- A17 Fusha 1 - Aneksi 1.4 - Rregullorja e Përgjithshme - anglisht
- A18 Fusha 1 - Aneksi 1.5.1- Organigrama 2014 - shqip
- A19 Fusha 1 - Aneksi 1.5.1 - Organigrama 2014 - anglisht
- A20 Fusha 1 - Aneksi 1.5.2 - Organigrama 2016 - shqip
- A21 Fusha 1 - Aneksi 1.5.2 - Organigrama 2016 - anglisht
- A22 Fusha 1 - Aneksi 1.6 - Vendim Senati për përbërjen e Këshillit të Etikës
- A23 Fusha 1 - Aneksi 1.7 - Kodi i Etikës
- A24 Fusha 1 - Aneksi 1.8 - Miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për Rektordin dhe Dekanët
- A25 Fusha 1 - Aneksi 1.9 - Vendim Rektori për Përgjegjësit e Departamenteve
- A26 Fusha 1 - Aneksi 1.10 - Procesi i vendimmarrjes për pasurimin kurrikular të programeve
- A27 Fusha 1 - Aneksi 1.10-1 - Vendim Senati për përbërjen e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- A28 Fusha 1 - Aneksi 1.11.1 - Përditësimi i Strategjisë së Zhvillimit 2012-2017 në vitin 2014
- A29 Fusha 1 - Aneksi 1.11.2 - Strategjia e Zhvillimit 2012-2017
- A30 Fusha 1 - Aneksi 1.12 - Procedura e vendimmarrjes së ndryshimit të Strategjisë në 2014 dhe plani buxhetor 3-vjeçar 2015-2017
- A31 Fusha 1 - Aneksi 1.13 - Raporti Vjetor 2015-2016
- A32 Fusha 1 - Aneksi 1.14 - Lista e Pedagogëve sipas departamenteve për vitin akademik 2016-2017
- A33 Fusha 1 - Aneksi 1.15 - Marrëveshje tip e TBU-së me partnerë të biznesit
- A34 Fusha 1 - Aneksi 1.16 - Marrëveshje e TBU-së me School of American Law
- A35 Fusha 1 - Aneksi 1.17 - Korrespondenca me MAS për Konkursin Kombëtar të TBU-së për Sipërmarrësit dhe Juristët e së Nesërme, 2016
- A36 Fusha 1 - Aneksi 1.18 - Shembull Syllabus me literaturë shqip dhe anglisht
- A37 Fusha 2 - Aneksi 2.1 - Rregullore për Rekrutimin e Personelit Akademik
- A38 Fusha 2 - Aneksi 2.2 - Konkluzionet e Inspektimit të MAS për procedurat e rekrutimit të personelit akademik në TBU, Maj 2015

- A39 Fusha 2 - Aneksi 2.3 - Procedura e vendimmarrjes së buxhetit të vitit 2017 dhe planit buxhetor 2017-2019
- A40 Fusha 2 - Aneksi 2.4 - Raporti i Auditimit për vitin fiskal 2015
- A41 Fusha 2 - Aneksi 2.5 - Inventari i pajisjeve deri në 31 Dhjetor 2016
- A42 Fusha 2 - Aneksi 2.6 - Raporti Vjetor 2014-2015
- A43 Fusha 2 - Aneksi 2.6-1 - Lista e aseteve të përfshira në projektin Erasmus+ KA2 ku bën pjesë TBU
- A44 Fusha 2 - Aneksi 2.7 - Shembull Syllabus të një lënde me botime të viteve të fundit
- A45 Fusha 2 - Aneksi 2.8 - Raporti i MAS për inspektimin e kryer në TBU për kapacitetet pritëse, 2016
- A46 Fusha 2 - Aneksi 2.9 - Rregullore për Sekretarinë Mësimore
- A47 Fusha 3 - Aneksi 3.1.1 - Rregullore e Programit Bachelor në Administrim Biznesi, Profili Menaxhim
- A48 Fusha 3 - Aneksi 3.1.2 - Rregullore e Programit Bachelor në E Drejtë Biznesi
- A49 Fusha 3 - Aneksi 3.1.3 - Rregullore e Programit Master Profesional në Administrim Biznesi
- A50 Fusha 3 - Aneksi 3.1.4 - Rregullore e Programit Master Profesional në E Drejtë Biznesi
- A51 Fusha 3 - Aneksi 3.2 - Vendim Senati mbi strukturën akademike 2016-2017 dhe planet mësimore
- A52 Fusha 3 - Aneksi 3.3 - Kontrata tip e punësimit për stafin akademik
- A53 Fusha 3 - Aneksi 3.4 - Model Suplementi të Diplomës Bachelor në Administrim Biznesi, profili Menaxhim, deri në vitin akademik 2014-2015
- A54 Fusha 3 - Aneksi 3.5.1 - Shembull Vendim Ekuivalentimi për studentë të transferuar në TBU nga Universitet jashtë vendit
- A55 Fusha 3 - Aneksi 3.5.2 - Shembull Vendim Ekuivalentimi për studentë të transferuar në TBU nga universitet brenda vendit
- A56 Fusha 4 - Aneksi 4.1.1 - Planet mësimore 2016-2017 Bachelor Administrim Biznesi
- A57 Fusha 4 - Aneksi 4.1.2 - Planet mësimore 2016-2017 Bachelor E Drejtë Biznesi
- A58 Fusha 4 - Aneksi 4.1.3 - Planet mësimore 2016-2017 Master Administrim Biznesi (të gjitha programet)
- A59 Fusha 4 - Aneksi 4.1.4 - Planet mësimore 2016-2017 Master E Drejtë Biznesi
- A60 Fusha 4 - Aneksi 4.2 - Rregullorja e Praktikes Mësimore / Internships
- A61 Fusha 4 - Aneksi 4.3 - Vendim Dekani për përcaktimin e Pedagogut Udhëheqës për Praktikat Mësimore
- A62 Fusha 4 - Aneksi 4.4 - Vendime të Përgjegjësit të Departamentit për Temat e Diplomave dhe Udhëheqësit, për vitin akademik 2015-2016
- A63 Fusha 4 - Aneksi 4.5 - Rregullore për Mbarëvajtjen e Procesit Mësimor
- A64 Fusha 4 - Aneksi 4.6 - Udhëzimi për Temën e Diplomës
- A65 Fusha 5 - Aneksi 5.1 - Vendimi i Rektorit për krijimin e komisionit pritës për aplikantët në vitin akademik 2016-2017
- A66 Fusha 5 - Aneksi 5.2 - Shembull transferimi i një studenti nga programi Master Profesional në Master të Shkencave në TBU
- A67 GID_TBU FINAL ME FIRMË
- A68 Aneksi H2 - Rezultatet e praktikës Raiffeisen Bank - anglisht.pdf
- A69 Fusha 1 - Aneksi 1.10 - Procesi i vendimmarrjes ndryshim plani mësimor 15-16 - anglisht.pdf
- A70 Fusha 1 - Aneksi 1.12 - Procesi i vendimmarrjes për ndryshimin e Strategjisë dhe planin buxhetor 3- vjeçar - anglisht.pdf
- A71 Fusha 1 - Aneksi 1.14 TBU_lëndët_pedagogët_2016_2017 - anglisht.xls
- A72 Fusha 1 - Aneksi 1.18 - TBU Syllabus - Biznesi Ndërkombëtar - anglisht.pdf

- A73 Fusha 2 - Aneksi 2.3 Procedura e vendimmarrjes së buxhetit 2017 dhe planit 2017-2019 - anglisht.pdf
- A74 Fusha 2 - Aneksi 2.7 Shembull Syllabus Menaxhimi Strategjik TBU-anglisht.pdf
- A75 Fusha 3 - Aneksi 3.2 Vendim senati Struktura Akademike 2016-2017- anglisht (1).pdf
- A76 Fusha 5 - Aneksi 5.1 Urdhër rektori 19.08.2016 komisioni pritës intervistat-anglisht.pdf

Lista 4

Këto u dorëzuan me kërkesë të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për qartësim të dokumenteve mbështetëse origjinale. Këto dokumente referohen në raport si '**B1**', '**B2**', etj.

- B1 Dokumente shtesë të kërkuara nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm_Përgjigje.pdf
- B2 Aneksi 1.2 Statuti i TBU-së 2014-anglisht.pdf
- B3 Aneksi 1.3 Statuti i TBU-së 2016- anglisht.pdf
- B4 Aneksi 1.4 Rregullorja e Përgjithshme e TBU-së anglisht.pdf
- B5 Aneksi 1.6 Vendim i Senatit Akademik të TBU-së për përbërjen e stafit të Këshillit të Etikës - anglisht.pdf
- B6 Aneksi 1.7 Kodi i Etikës i TBU-së - anglisht.pdf
- B7 Aneksi 1.8 – Vendim i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të TBU-së për emërimin e Rektorit dhe Dekanëve - anglisht.pdf
- B8 Aneksi 1.9 Vendimi i Rektorit të TBU-së për emërimin e përgjegjësit të departamenteve dhe kryetarëve të qendrave për të dyja fakultetet - anglisht.pdf
- B9 Aneksi 1.10-1 Vendim i Senatit Akademik të TBU-së për miratimin e përbërjes së stafit të NjSBC-së - anglisht.pdf
- B10 Aneksi 1.11.1 Ndryshime në Strategjinë e Zhvillimit 2012-2017 anglisht.pdf
- B11 Aneksi 1.11.2 – Strategjia e Zhvillimit e TBU-së 2012-2017 - anglisht.pdf
- B12 Aneksi 1.13 – Raporti Vjetor i TBU-së 2015-2016 - anglisht.pdf
- B13 Aneksi 1.14 Stafit akademik dhe lëndët e TBU-së 2016-2017 - anglisht.xls
- B14 Aneksi 1.15 Marrëveshje Bashkëpunimi e TBU-së me Partnerët e Biznesit - model anglisht.pdf
- B15 Aneksi 1.17 Korrespondenca e TBU-së me MAS për 2 konkurse kombëtare 2016 - anglisht.pdf
- B16 Aneksi 2.1 Rregullore e TBU-së për rekrutimin e stafit akademik - anglisht.pdf
- B17 Aneksi 2.2 Konkluzionet e Inspektimit të MAS për procedurat e rekrutimit të personelit akademik 2015 - anglisht.pdf
- B18 Aneksi 2.4 Raport i Auditimit të TBU-së - anglisht.pdf
- B19 Aneksi 2.5 Inventari i TBU-së deri më 31.12.2016 - anglisht.xls
- B20 Aneksi 2.6 Raporti Vjetori i TBU-së 2014-2015 - anglisht.pdf
- B21 Aneksi 2.8 Raporti i MAS për inspektimin dhe verifikimin e kryer në TBU për kapacitetin dhe infrastrukturën 2016 - anglisht.pdf
- B22 Aneksi 2.9 Rregullore e TBU-së për Sekretarinë Mësimore - anglisht.pdf
- B23 Aneksi 3.1.1. Rregullore e TBU-së për Programin Bachelor në Administrim Biznesi - anglisht.pdf
- B24 Aneksi 3.1.2 Rregullore e TBU-së për Programin Bachelor në E Drejtë Biznesi - anglisht.pdf
- B25 Aneksi 3.1.3 Rregullore e TBU-së për Programin Master Profesional në Administrim Biznesi - anglisht.pdf
- B26 Aneksi 3.1.4 Rregullore e TBU-së për Programin Master Profesional në E Drejtë Biznesi - anglisht.pdf

- B27 Aneksi 3.3. Kontrata tip e punës për stafin akademik 2015-2016 - anglisht.pdf
- B28 Aneksi 3.5.1 Studentët e transferuar në TBU nga universitetet jashtë vendit - anglisht.pdf
- B29 Aneksi 3.5.2 Studentët e transferuar në TBU nga universitetet brenda vendit - anglisht.pdf
- B30 Aneksi 4.1.1 Planet mësimore 2016-2017 Bachelor Administrim Biznesi 2016-2017 - anglisht.pdf
- B31 Aneksi 4.1.2 Planet mësimore 2016-2017 Bachelor E Drejtë Biznesi 2016-2017 - anglisht.pdf
- B32 Aneksi 4.1.3 Planet mësimore 2016-2017 Master Administrim Biznesi 2016-2017 - anglisht.pdf
- B33 Aneksi 4.1.4 Planet mësimore 2016-2017 Master E Drejtë Biznesi 2016-2017 - anglisht.pdf
- B34 Aneksi 4.2 Rregullorja e Praktikes Mësimore / Internships - anglisht.pdf
- B35 Aneksi 4.3 Vendim i Dekanit për caktimin e Pedagogut Udhëheqës për Praktikat Mësimore - 2016-2017 - anglisht.pdf
- B36 Aneksi 4.4. Vendime për Temat e Diplomave dhe Udhëheqësit 2015-2016 - anglisht.pdf
- B37 Aneksi 4.5 Rregullore për Mbarëvajtjen e Procesit Mësimor - anglisht.pdf
- B38 Aneksi 4.6 Udhëzimi për Temën e Diplomës - anglisht.pdf
- B39 Aneksi 5.2 - Shembull transferimi i një studenti ndërmjet programeve brenda TBU-së - anglisht.pdf
- B40 Aneksi H1.1 Shkresë e ardhur nga MAS për riorganizimin – prill 2017 - anglisht.pdf
- B41 Aneksi H1.2 Shkresë e TBU dërguar MAS për riorganizimin institucional - anglisht.pdf
- B42 Aneksi S 1 – Procedura e vendimmarrjes për miratimin e Statutit të TBU-së 2016 - anglisht.pdf
- B43 Aneksi S 2 - Procedura e vendimmarrjes për miratimin e Rregulloreve - anglisht.pdf
- B44 Aneksi S 3-Axhenda & Procesverbali i Vendimit të Senatit 15 prill 2016.pdf
- B45 Aneksi S 4-Axhenda & Procesverbali i Vendimit të Senatit 17 tetor 2016.pdf
- B46 Aneksi S 5-Axhenda & Procesverbali i Vendimit të Senatit 19 tetor 2016.pdf
- B47 Aneksi S 6-Axhenda & Procesverbali i mbledhjes së Bordit të Administrimit 3 tetor 2016.pdf
- B48 Aneksi S 7-Axhenda & Procesverbali i takimit të Bordit të Administrimit 10 dhjetor 2016.pdf
- B49 Aneksi S 8-Axhenda & Procesverbali i NjSBC-së tetor 2016.pdf
- B50 Aneksi S 9-Axhenda & Procesverbali i Këshillit të Etikës tetor 2016.pdf
- B51 Aneksi S 10 – Rregullore e Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë - anglisht.pdf
- B52 Aneksi S 11 Ngarkesa mësimore e stafit.xls
- B53 Aneksi S 12-Vendet e punësimit të të diplomuarve sipas programit.pdf
- B54 Aneksi S 14 Shembull i suplementit të diplomës.pdf
- B55 Aneksi S 15-Information bursa 2014-2015 & 2015-2016.pdf
- B56 Aneksi S 16 Njoftim i emailit dërguar për studentëve e vitit të 3-të të TBU-së në programin Bachelor për përzgjedhjen e profilit të tyre të programit të studimit - anglisht.pdf
- B57 Linku 11 – Angazhimi i stafit akademik të TBU-së në kërkimin shkencor.pdf
- B58 Aneksi S 13 – Rezultatet e mbledhura të pyetësorit të studentëve 2015-2016.xls
- B59 Aneksi S 1- Procedura e vendimmarrjes së Statutit 2016.pdf
- B60 Aneksi S 2 - Procedura e vendimmarrjes së rregulloreve.pdf
- B61 Aneksi S 3 - Axhenda dhe Procesverbali i Mbledhjes së Senatit 15 prill 2016.pdf

- B62 Aneksi S 4 - Axhenda dhe Procesverbali i Mbledhjes së Senatit 17 tetor 2016.pdf
- B63 Aneksi S 5 - Axhenda dhe Procesverbali i Vendimit të Senatit 19 tetor 2016.pdf
- B64 Aneksi S 6 - Axhenda dhe Procesverbali i Mbledhjes së Bordit tetor 2016.pdf
- B65 Aneksi S 7 - Axhenda dhe Procesverbali i Mbledhjes së Bordit dhjetor 2016.pdf
- B66 Aneksi S 8 - Axhenda dhe Procesverbali i Mbledhjes së NJSBC-së tetor 2016.pdf
- B67 Aneksi S 9 - Axhenda dhe Procesverbali i Mbledhjes së Këshillit të Etikës.pdf
- B68 Aneksi S 10 – Rregullore e_NjSBC-së.pdf
- B69 Aneksi S 11 - Plani i ngarkesës së stafit akademik 2016-2017.xlsx
- B70 Aneksi S 12 - TBU Alumni.pdf
- B71 Aneksi S 13 - Rezultate të përmbledhura të sondazheve të studentëve 2015-2016.xls
- B72 Aneksi S 14 - Shembull të një suplementi diplome.pdf
- B73 Aneksi S 15- Informacion bursat 2014-2015 & 2015-2016.pdf
- B74 Aneksi S 16 - Email dërguar studentëve viti III Bachelor profili.pdf

Lista 5

Këto dokumente universiteti i dorëzoi në vijim të kërkesave të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm gjatë vizitës së vlerësimit të jashtëm. Këto dokumente referohen në raport si 'C1', 'C2', etj.

- C1 Axhenda RT - TBU - 12-13 qershor.doc
- C2 Aneksi S17 - Zbërthimi i buxhetit për shpenzimet në kërkimin shkencor.pdf
- C3 Aneksi S17 - Budget breakdown for expenses on research.pdf
- C4 Aneksi S18 Plan veprimi për 2016 - 2017.pdf
- C5 Aneksi S18 - TBU action plan for 2016-2017.pdf
- C6 Aneksi S19 – Lista e kurseve të TBU-së që zhvillohen në gjuhën angleze.pdf

Mbledhjet e realizuara gjatë vizitës

Mbledhjet janë referuar në raport duke përdorur shkurtimet e mëposhtme:

Dita 1: E hënë 12 qershor 2017

- 08:45 - 09:00 **M1:** Mbledhje me Koordinatorin Institucional.
- 09:00 - 09:30 **M2:** Mbledhje me Rektorin.
- 10:00 - 11:00 **M3:** Mbledhje me Grupin e Vetëvlerësimit.
- 11:30 - 12:30 **M4:** Mbledhje me të gjithë anëtarët e Senatit Akademik (përfshirë Rektorin).
- 13:30 - 14:30 **M5:** Mbledhje me të gjithë anëtarët e Rektoratit dhe Bordit (përfshirë çdo individ që është takuar me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm).
- 15:00 - 16:00 **M6:** Mbledhje me një grup studentësh.
- 16:30 - 17:30 **M7:** Mbledhje me një grup partnerësh të jashtëm dhe alumni.
- 18:00 - 18:15 **M8:** Mbledhje me Koordinatorin Institucional për qartësimin e çështjeve të ngritura gjatë Ditës 1.

Dita 2: E martë 13 qershor 2017

- 09:00 - 09:30 **M9:** Mbledhje me Koordinatorin Institucional për qartësimin e çështjeve të ngritura.
- 09:30 - 10:30 **M10:** Mbledhje me grupin e stafit të mësimdhënies (përfshijë çdo individ që është takuar me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm).
- 11:00 - 12:00 **M11:** Mbledhje me një grup të personelit administrativ (përfshijë çdo individ që është takuar me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm).